



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Agim Ramadani Nr. 23, Prishtinë - Kosovë **Tel:** ++381 38 500 400 0 **Fax:** ++ 381 38 248 076

E-mail: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) (në tekstin e më tutjeshëm: "Agjencia"), duke u bazuar në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 (me ndryshime), nenin 68, të Ligjit, nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë dhe nenin 10.3 të Politikave Operacionale të Agjencisë, publikon:

FTESË PËR APLIKIM ME QËLLIM TË HARTIMIT TË LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PUNËTORËVE

Të gjithë punëtorët të cilët konsiderojnë se i plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e një pjese të të hyrave prej 20% nga privatizimi/likuidimi i **Nsh "Teuta Bare" në Mitrovicë (MIT030)**; si në vijim:

Organi përfaqësues i kësaj NSh-je nuk ka qenë bashkëpunues në finalizimin e listës fillestare ashtu si kërkohet me legjislacionin e aplikueshëm për një periudhë kohore për më shumë se një vit.

Me qëllim që të përfundojë procedura e pagesës të një pjese prej 20% nga çmimi i shitjes së **Nsh "Teuta Bare"**, Agjencia në mungesë të Listës së përkohshme përkatëse publikon këtë NJOFTIM me kërkesë që të gjithë punëtorët e kësaj NSh-je të plotësojnë formularin e bashkangjitur, dhe Agjencisë ti dërgojnë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me pikën 1, të formularit të bashkangjitur, në mënyrë që të realizohen të drejtat e punëtorëve në adresën e theksuar në fund të këtij njoftimi:

Emri i NSh-së	Nsh "Teuta Bare" në Mitrovicë	
Emri i parashtruesit të kërkesës		
PROVAT TË CILAT I BASHKANGJITEN ANKESËS		
1	Kopja e librezës së punës apo ndonjë dëshmi tjetër që konfirmon punësimin në këtë NSh. Të gjitha kopjet e dokumentacionit duhet të jenë të vërtetuara nga organi kompetent.	Po/Jo
2	Adresa: Nr. i tel:	Po/Jo
3	A konsideroni se jeni dëmtuar për shkak të diskriminimit	Po/Jo
4		Po/Jo

	Provat tjera shtesë lidhur me kërkesën	
	Kundërshtimi i ndonjë emri/emrave të punëtorëve të cilët janë aktualisht në listë	
5	Mbi cilën bazë kundërshtohet përfshirja e një apo më shumë emrave të punëtorëve në listë.	Po/Jo
	Nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës	Data:

Në rast se ankesa parashtrohet në emër të ushtruesit të ankesës nga pala e tretë (p.sh avokati), atëherë ai/ajo duhet të prezantojë autorizimin e vërtetuar me shkrim për të ndërmarrë veprime juridike në emrin e tij/saj.

TË GJITHA KËRKESAT NË LIDHJE ME KËTË NJOFTIM DUHET TË DORËZOHEN NË AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT DERI MË DATËN 17.06.2017 PARA PËRFUNDIMIT TË ORARIT TË PUNËS

Nëse është e nevojshme Agjencia, mund të kërkojë informata shtesë ose të mbajë seanca dëgjimore për t'i shqyrtuar drejt kërkesat, ankesat apo kundërshtimet.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Rr." Agim Ramadani Nr.23 Prishtinë
10 000 Prishtinë,
Kosovë
Tel: ++381 38 500 400 ext 0. Fax-i: ++ 381 38 248 076
Posta elektronike: info@pak-ks.org